



VENDIM

Nr. 89, Datë 09.06.2016

MBI

KËRKESËN E SHOQËRISË ALB WIND ENERGY SHPK, PËR SHTYRJEN E AFATEVE TE LICENSES NR. 53, SERIA NPM08P, PER NDERTIM, INSTALIM, SHFRYTEZIMIN DHE PRODHIMIN E ENERGJISE ELEKTRIKE NGA CENTRALE EOLIKE (PROJEKTI VISU DHE PROJEKTI TERPAN)”, TE DHENE ME VENDIMIN E BORDIT TE KOMISIONEREVE ERE-S ME NR. 13, DATE 28.01.2008, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 16 dhe 42, gërma “a” të Ligjit 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë të Elektrike” Nenit 5 dhe 6, të “Rregullores për Procedurat e Heqjes së një Liçense, neneve 16 pika 2 dhe 18 të Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE miratuar me vendimin nr 21, datë 18.03.2009, i ndryshuar pikës 1.2; 1.6 dhe 1.7 të kushteve të licensës nr. 53, seria NPM08, “Për ndërtim, instalim, shfrytëzimin dhe prodhimin e energjisë elektrike nga centrale eolike (Projekti VISU dhe projekti TERPAN)”, të dhënë me Vendimin e Bordit të Komisionereve të ERE-s me Nr. 13, date 28.01.2008, i ndryshuar, Bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 09.06.2016, mbasi shqyrtoi informacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, për shtyrjen e afateve për realizimin e kushteve të vendosura nga ERE në licencën e shoqërisë “ALB WIND ENERGY “ sh.p.k,

Konstatohet se:

- Duke mbajtur në konsideratë rëndësinë e investimit dhe me qëllim mbështetjen dhe nxitjen e ndërtimit të Burimeve të Rinovueshme të Energjisë ERE ka pranuar kërkesat e shoqërisë “ALB WIND ENERGY” sh.p.k në lidhje me shtyrjen e afateve për realizimin e projektit duke përfshirë këtu edhe kolaudimin e veprës.
- ERE ka miratuar shtyrjen e afateve me vendimet :
 - Vendimin e Bordit të Komisionereve Nr. 68, date 13.09.2010,
 - Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 139, date 15.11.2013.

- Me shkresën me Nr. Extra Prot., date 23.012.2014, shoqëria “ALB WIND ENERGY” sh.p.k, ka paraqitur një kërkesë tjetër për shtyrjen me 24 muaj të afateve të licensës së ndërtimit të dhënë me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s me nr. 13, datë 28.01.2008, i ndryshuar së fundmi me vendimin Nr. 139, date 15.11.2013.
- Mospërbushja e pikës 4 të vendimit nr. 13 datë 28.01.2008, i ndryshuar e bën licencën të pavlefshme.
- Kur nuk përmbushen kushtet thelbësore të licensës së dhënë, sipas ligjit nr.43/2015 "Për sektorin e energjise elektrike", ERE me iniciativën e vetë mund të heqë licencën.

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Rrezimin e kërkesës së shoqërisë “ALB WIND ENERGY” sh.p.k, për zgjatjen e afatit të Ndërtim, Instalim, Shfrytëzimin të Centrale Elektrike dhe prodhimin e energjisë elektrike nga Parku Eolik “Projekti VISU dhe projekti TERPAN”.
- 2- Fillimin e procedurave për heqjen e licensës së shoqërisë “ALB WIND ENERGY” sh.p.k, nr. 53, seria NPM08P.
- 3- Ngarkohet Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë shoqërinë për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE
Petrit AHMETI